

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS	Nr. i Prot. / Prot. No. 07-1 615-1.
Nr. i Agjendës / Agenda No. 03	Data / Date: 03.05.2018
Prishtinë	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška Investicije – Ministry of Diaspora and Strategic Investments

Prishtinë,
Datë: 03.05.2018

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike bën:

Shpallje të konkursit
për marrëveshje për shërbime të veçanta

<i>Emri i Institucionit:</i>	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike
<i>Njësia Organizative:</i>	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
<i>Titulli i punës:</i>	Ndihmës i përgjegjës të Bazës së të dhënave:
<i>Numri i referencës:</i>	MDIS/01/2018 /M.SH.V/8
<i>Tarifa e shërbimit:</i>	395 € bruto
<i>Raporton te:</i>	Përgjegjës të bazës së të dhënave
<i>Lloji i kontratës:</i>	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
<i>Kohëzgjatja e kontratës:</i>	5 muaj 29 ditë
<i>Orari i punës:</i>	I plotë
<i>Numri i ekzekutuesve:</i>	1 (një)
<i>Vendi:</i>	Prishtinë
<i>Data e përafërt e fillimit:</i>	11.05. 2018

Detyrat dhe përgjegjësitë e ndihmësit të përgjegjës të Bazës së të dhënave:

- Detyra 1:** Ndihmon në mirëmbajtje të platformës, përfshirjen, përpunimin e të dhënave për Hartimin e Regjistrimit për Diasporën dhe Mërgatën si dhe Përditësimin e tij;
- Detyra 2:** Ndihmon në Programim e softuerëve aplikativ Net, Csprox, MySql, kujdeset për menaxhimin e serverit;
- Detyra 3:** Është përgjegjës për bazën e të dhënave dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tyre;
- Detyra 4:** Bën azhurnimin e të dhënave në baza ditore, javore, mujore dhe sipas nevojës, varësisht nga burimi i të dhënave;
- Detyra 5:** Asiston në përgatitjen dhe përmbajtjen e tabelave për nevojat e publikimeve të ndryshme;
- Detyra 6:** Përpilimi i dizajnit funksional dhe specifikimit teknik të aplikacioneve;

Detyra 7: Koordinimin me gjuhë të ndryshme programuese dhe vegla të ndryshme programuese të avancuara sipas standardeve bashkëkohore të TI-së;

Detyra 8: Është përgjegjës për ruajtjen e të dhënave;

Detyra 9: Bën krahasimin dhe sigurimin e të dhënave;

Detyra 10: Ndhmon zyrtarët tjerë në zhvillimin e aplikacioneve dhe mirëmban rrjetin dhe Ueb-faqen që kanë të bëjnë me Hartimin e Regjistrimit të Diasporës dhe Mërgatës dhe përditësimin e tij;

Detyra 11: Kryen dhe detyra shtesë të deleguara nga Udhëheqësit që kanë të bëjnë me TI.

Shkathtësitë e kërkuara: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Njohja e gjuhës Angleze e obliguar;
- Të jetë i aftë të përballojë dhe të organizojë punën;
- Njohja e mirë e SPSS, MS-Office, programeve statistikore dhe të ngjashme;
- Aftësi në punë nën presion dhe fleksibilitet;

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë konkurs:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12, paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike / Divizioni për Burimeve Njerëzore, Rr. "Zenel Salihu", objekti i ish-Gjykatës Themelore të Prishtinës, kati përdhësë ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <http://medrks-gov.net/>

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Tel. 038 200 17 024, prej orës 8:00 – 16:00.

- *Konkursi mbetet i hapur 7 ditë kalendarike, nga dita e publikimit 03. 05. 2018 deri më: 09. 05. 2018, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.*
- *Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda ditëve sa shpallja mbetet e hapur, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.*
- *Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.*
- *Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!*
- *Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.*
- *Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit. Ata janë të obliguar t'i sjellin me vete dokumentet origjinale për kualifikimet dhe trajnimet e kryera, për verifikim para komisionit intervistues.*

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.